



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 1. REGJISTRI TË PARAQITUR NË KQZ  
NGA PARTIA BINDJA DEMOKRATIKE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

**KËRKUES:** Partia "Bindja Demokratike"

**PALË TË INTERESUARA:** Z. Pavllo Shkarpa  
Individ të cilit i është rrëzuar kërkesa për rregjistrimin si kandidat për kryetar, Bashkia Berat

**OBJEKT:** Kundërshtimi i Vendimit nr.4 datë 18.05.2019 të KZAZ nr .64  
"Për mosregjistrimin e Kandidatit për Kryetar Bashkie Berat z.Pavllo Shkarpa Hoxhaj propozuar nga Partia Bindja Demokratike"

**BAZË LIGJORE:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 109 të Kushtetutës, nenet 68; 70; 71; 72 73; 124, 143, pika 1, germa "b" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e palëve,



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**  
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

## VËREN

Partia Bindja ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore nr.1, datë 21.05.2019, me objekt "Kundërshtimi i Vendimit nr.4, datë 18.05.2019, të KZAZ nr.64 "Për mosregjistrimin e Kandidatit për Kryetar Bashkie Berat z. Pavllo Shkarpa propozuar nga subjekti politik Partia Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019."

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenet 134 e vijues të Kodit Zgjedhor, në seancën plenare të datës 23.05.2019, ora 11:00, zhvilloi shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore nr.1 regj., sipas objektit të sipërcituar.

Në mbledhjen e datës 23.05.2019, KQZ përpara nisjes së hetimit administrativ në mbështetje të nenit 135, pika 3 verifikoi legjitimitetin e palëve dhe konstatoi se për ankimin nr. 1 subjekti ankues i vetëm, është Partia Bindja Demokratike.

Gjithashtu, KQZ pasi verifikoi pjesëmarrjen e ankuesit mori në shqyrtim kërkesën e z. Pavllo Shkarpa për të marrë pjesë në shqyrtimin administrativ të ankimit, si palë e interesuar, me cilësinë e individit të cilit i është refuzuar kërkesa për regjistrim si kandidat për kryetar bashkie, dhe pasi i çmoi këto kërkesa në përputhje me kërkesat e nenit 133, pika 1, 2 dhe 3, të ligjit Nr. 10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", vendosi pranimin e z. Pavllo Shkarpa si palë e interesuar.

- Pala ankuese në ankimin e paraqitur në datë 21.05.2019 pretendon se:

Me vendimin nr.4 datë 18.05.2019 të KZAZ nr.64, Bashkia Berat, ka vendosur mosregjistrimin si kandidat për kryetar bashkie të z. Pavllo Shkarpa, propozuar nga subjekti Bindja Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019. Z. Pavllo Shkarpa më datë 13.05.2019, bazuar në nenin 67 pika 1 e Kodit Zgjedhor ka depozituar kërkesën për regjistrimin si kandidat për kryetar Bashkia Berat, pranë KZAZ-së nr. 64.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datë 30 qershor 2019 afati i fundit i përlogaritur është data 13 maj 2019.

KZAZ nr. 64 ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga z. Shkarpa dhe ka arsyetuar se z. Shkarpa nuk është banor i Bashkisë Berat me datë 13 maj 2019 kusht i përcaktuar në nenin 109 të Kushtetutës dhe nuk mund të regjistrohet si kandidat për kryetar bashkie.

Vendimi i sipërcituar i KZAZ-nr. 64, sipas ankuesit është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe nenin 109 të Kushtetutës. Kushti i vendbanimit nuk është i vetëm për të mundur regjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Z. Shkarpa është banor i Bashkisë Berat me datë 16 maj 2019. Kushtetuta dhe ligji nuk e lidh vendbanimin e përhershëm me të drejtën për të kandiduar por me të drejtën për tu zgjedhur. Afati 13 maj 2019, nuk është afati ligjor për të qenë banor i përhershëm i njësisë vendore, si kusht për tu regjistruar. Vendimi i KZAZ-së nr.64 është i pambështetur në prova dhe në ligj.

- Z. Pavllo Shkarpa me cilësinë e palës së interesuar parashtrojë se:



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

Për të qenë kandidat është e parëndësishme fakti se ne cilën datë je banor i përhershëm i njësisë vendore përkatëse, e rëndësishme është fakti i lidhjes shpirtërore, origjinës, ushtrimit të aktiviteteve të biznesit që ka individi me qytetin. Në mungesë të marrjes së shërbimeve nga zyrat e njësisë vendore për një periudhë 15 vjeçare, z. Shkarpa ishte në padijeni për njësinë vendore ku kishte vendbanimin.

Pas paraqitjes së pretendimeve të palëve, për nevoja të hetimit administrativ, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi të administrojë kryesisht në përputhje me nenin 136, pika 2 dokumentacionin e depozituar nga Partia Bindja Demokratike për regjistrimin e z. Pavllo Shkarpa pranë KZAZ nr. 64.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstaton se:

Neni 72 i Kodit Zgjedhor liston përmbajtjen e dokumenteve të kandidimit, dhe në pikën "b)" citojmë: "emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, adresën e kandidatit dhe një kopje të dokumentit të identifikimit".

Në mbështetje të nenit 92 shkronja "gj" dhe nenit 93 të kushtetutës së Republikës së Shqipërisë , si dhe ne zbatim te rregullave te parashikuara në nenin 9 , paragrafi 1 dhe 2 te ligjit nr. 10019 datë29.12.2008 " Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

Në datën 05.11.2018 me dekretin nr.10928, Presidenti i Republikës ka caktuar datën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore në 30 Qershor 2019.

Bazuar në Nenin 67 pika 1 e Kodit Zgjedhor citon, Partia politike, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë.

Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 afati i fundit i përllogaritur është data 13 maj 2019.

Neni 72 i Kodit Zgjedhor liston përmbajtjen e dokumenteve të kandidimit, dhe në pikën "b)" citojmë: "emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, adresën e kandidatit dhe një kopje të dokumentit të identifikimit".

Ndër të tjera, të dhënat personale të sipërcituara shërbejnë për të verifikuar përmbushjen e detyrimit kushtetues të parashikuar nga neni 109/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit "Të drejtën e zgjedhjes në këshillat vendorë dhe si kryetar bashkie ose komune e kanë vetëm shtetasit që janë me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse."

Rezulton e provuar dhe e pranuar nga ankuesi se Kandidati për Kryetar në Bashkinë Berat z. Pavlo Koli Shkarpa ne datën 13.05.2019, që përbën edhe afatin përfundimtar të parashikuar



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

sipas nenin 67 pika 1 e Kodit Zgjedhor për regjistrimin e Kandidateve, ka qenë banor i njësisë administrative nr. 5 Tiranë.

Me shkresën nr.2644/1 protokolli, datë 16.05.2019 të Z.Gj.Civile nr.3, Bashkia Berat, konfirmohet se z. Pavlo Koli Shkarpa është bërë banor i Bashkisë Berat në datë 16.05.2019.

Bazuar në faktet e rrethanat e sa më sipërme dhe me arsyetimin se Kandidatura e z. Pavlo Koli Shkarpa është në kundërshtim parashikimin e nenit 109/3 të Kushtetutës së Shqipërisë, KZAZ nr.64, Qarku Berat, pranë së cilës z. Shkarpa ka depozituar dokumentet e kandidimit, me Vendimin nr.4, datë 18.05.2019 ka vendosur "Të mos regjistrojë si kandidat për Kryetar Bashkie në Bashkinë Berat për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 z. Pavlo Koli Shkarpa, paraqitur nga subjekti zgjedhor Partia Bindja Demokratike"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në lidhje me këtë çështje sjell në vëmendje Vendimin nr.40, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese, e cila ndër të tjera është shprehur se:

"E drejta e votës nuk është absolute, ajo mund të bëhet objekt i kufizimeve. Për vetë rëndësinë që merr kjo e drejtë në një shoqëri demokratike, kufizimet që i duhen bërë kësaj të drejte jo vetëm duhet të jenë të pakta, por ato duhen zbatuar brenda kufijve kushtetues. E rëndësishme është që kufizimet të mos jenë të tilla që ta bëjnë jo efektiv ushtrimin e kësaj të drejte ose ta cenojë atë në thelbin e saj, pasi e drejta e votës nuk është një privilegj që pushteti shtetëror ua njeh shtetasve, por një instrument për të zgjedhur mënyrën dhe personat që do të qeverisin vetë ata. Duke ushtruar të drejtën e votës zgjedhësit i krijohet mundësia të ndikojë në mënyrën dhe cilësinë e funksionimit të rendit juridik duke e bërë shtetasin më të përgjegjshëm për rolin që ai ka në drejtimin e jetës së vendit. Ky është në fakt edhe thelbi i demokracisë."

Neni 18 i Kushtetutës, hedh dritë më tej mbi shprehjen "kufizimet të mos jenë të tilla", duke vërejtur që "Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore."

Vijon më tej Gj.K në vendimin e sipërcituar:

"Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 45 të saj, parashikon të drejtën e çdo individi mbi 18 vjeç të zgjedhë e të zgjidhet. Përrjashtim bëjnë personat të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim gjyqësor të formës së prerë për paaftësi mendore. Gjithashtu, paragrafi 3 i këtij neni parashikon se të dënuarit që janë duke vuajtur dënimin me heqje të lirisë kanë vetëm të drejtën për të zgjedhur. Ky parashikim kushtetues është brenda standardeve demokratike dhe bashkëkohore.

Gjykata Kushtetuese thekson se teoria e së drejtës kushtetuese si dhe praktika gjyqësore evropiane e quan të pranueshme dhe të justifikuar vendosjen e kriterëve të tilla si, mosha minimum ose vendbanimi në një zonë të caktuar, përfshirja në lista zgjedhësish apo pasja e shtetësisë së vendit ku zhvillohen zgjedhjet si dhe aftësia mendore për të shprehur vullnetin politik.

Kushti për të pasur vendbanimin në zonën zgjedhore është një nga kufizimet e të drejtës së votës, e cila bashkë me kriterin e shtetësisë synojnë të vendosin një lidhje direkte, qoftë edhe



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

minimale, midis votuesit dhe rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë sigurohet legjitimiteti i votës në një zonë të caktuar.”

Ankimuesi pretendon se periudha “jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve” që përcakton sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor edhe afatin maksimal që ligji iu jep subjekteve zgjedhore për tu regjistruar në një proces zgjedhor nuk ka lidhje me detyrimin e parashikuar në nenin 109/3 të Kushtetutës. Logjika e ankuesit është se, një kandidat ka hapësirë të fitojë statusin e banorit të përhershëm të zonës në çdo ditë përpara datës së zgjedhjeve, madje edhe ditën e zgjedhjeve, pa u lidhur kjo me afatin përfundimtar për tu regjistruar si kandidat në zgjedhje.

Në këtë pikë KQZ vlerëson se duhet të ndalet për të theksuar rolin dhe rëndësinë që kanë afatet e parashikuara nga Kodi Zgjedhor në lidhje me disiplinimin e procesit zgjedhor. Në Vendimin nr.18, datë 05.06.2015 “Kolegji Zgjedhor vlerëson se referuar parashikimeve të neneve 67, 70, 72 dhe 73 të Kodit Zgjedhor, procesi i regjistrimit të kandidatit për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore kalon nëpër disa faza të përcaktuara në afate kohore, deri në përmbylljen përfundimtare të tij dhe konkretisht, faza e paraqitjes së kërkesës, faza e verifikimit të dokumentacionit dhe faza finale e miratimit të kërkesës dhe regjistrimit të kandidatit të propozuar. Kandidati i propozuar, me regjistrimin e tij zyrtarisht si i tillë, fiton statusin e subjektit zgjedhor, pra të një subjekti të veshur me cilësi të posaçme, duke qenë kështu një nga subjektet e procesit ligjor zgjedhor, që si i tillë, ligji (Kodi Zgjedhor) i jep atij të drejta individuale, por e ngarkon dhe me detyrime. Në këtë kuptim, realizimi/fitimi nga një shtetas, nëpërmjet regjistrimit, të të drejtës për t’u kandiduar si kryetar i një njësie të qeverisjes vendore passjell për kandidatin përgjegjësi (të drejta dhe detyrime) në raport me procesin zgjedhor, subjektet pjesëmarrëse dhe zgjedhësit.”

Nëse e drejta e kandidatit për të respektuar detyrimin kushtetues të sanksionuar nga neni 109/3 i Kushtetutës do të trajtohej ashtu sikundër e vlerëson kandidati, më shumë herët sesa vonë do të ndodheshim përpara situatave kur kandidatë të ndryshëm, të regjistruar në KZAZ përkatëse dhe të listuar në fletën e votimit mund të mos ishin regjistruar ende si banorë të përhershëm të zonës zgjedhore, me pasojën që kjo të mos ndodhte edhe pas datës së zgjedhjeve e për rrjedhim paligjshmërinë absolute të zgjedhjes së kandidatit dhe përsëritjen e zgjedhjeve.

Në lidhje me dokumentacionin e kandidimit, nisur nga problematikat e shfaqura në zgjedhjet e vitit 2015, OSBE-ODIHR, në raportin përfundimtar për monitorimin e zgjedhjeve të vitit 2015, ka rekomanduar rregulla të qarta për regjistrimin e kandidatëve dhe vlefshmërinë e firmave mbështetëse.

Në Rekomandimin nr.11 të Raportit të OSCE/ODIHR 2015 thuhet “Rregullat për regjistrimin e kandidatëve, duke përfshirë procedurat për mbledhjen, verifikimin, dhe vlefshmërinë e firmave mbështetëse, duhet të jenë të qarta dhe të rregulluara mjaftueshëm para zgjedhjeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe siguri ligjore”.

Arsyetimi se kushtet për të kandiduar në ditën e zgjedhjeve, mund të plotësohen edhe pas regjistrimit të kandidatëve, sjell paqartësi dhe pabarazi të subjekteve zgjedhore që do të garojnë.

Detyrimi për tu regjistruar në respektim të të gjitha kërkesave të tjera të Kushtetutës dhe të ligjit “jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve” është një afat që disiplinon procesin zgjedhor, ai i vendos kandidatët në kushte të njëjta e të barabarta garimi dhe iu krijon strukturave të



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**

Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

administrimit të zgjedhjeve, KQZ më e para, mundësitë e nevojshme për të përgatitur logjistikën e domosdoshme për realizimin e zgjedhjeve në kohën e përcaktuar.

Interpretimi i nenit 109/3 të Kushtetutës duhet bërë nën dritën e qëllimit të plotë të tij, i cili është jo thjesht njohja e të drejtës për të zgjedhur e për tu zgjedhur, por edhe garantimi i kësaj të drejte, që mundësohet nga zbatimi me korrektesë i afateve kohore të përcaktuara nga dispozitat e Kodit Zgjedhor. Çdo interpretim i veçuar dhe evaziv i normës kushtetuese, më së paku do të krijonte një situatë paqartësie të strukturave të administrimit zgjedhor përse i përket statusit përfundimtar të një kandidati për tu zgjedhur, duke qenë se ky status do të jetë vazhdimisht i dyshimtë përse kohë që kandidati nuk është regjistruar si banor i përhershëm i zonës zgjedhore.

Akoma më tej, do të vihej në pikëpyetje edhe serioziteti dhe marrëdhënie e kandidatit me zgjedhësit e tij dhe komunitetin që ai supozohet se do përkujdeset në rast zgjedhje. Siç thekson edhe Gjykata Kushtetuese "Në rastin e zgjedhjeve vendore... synohet një lidhje më e ngushtë midis zgjedhësit dhe të zgjedhurit për vetë natyrën e organizimit dhe kompetencave të pushtetit lokal. Është pushteti vendor që kujdeset për zgjidhjen e problemeve aktuale të qytetarëve që lidhen me çështje të tilla si punësimi, kujdesi shëndetësor, arsimiti parashkollor, pastrimi dhe gjelbërimi i mjediseve të njësisë vendore, etj. Për këtë arsye, votimi në zgjedhjet vendore trajtohet si pjesë e strukturës së demokracisë nga poshtë lart duke u mundësuar zgjedhësve pjesëmarrjen në qeverisje edhe në forumet më të vogla, përveç parlamentit kombëtar. Në këtë këndvështrim, pranohet se pushteti lokal është më afër qytetarëve dhe këta të fundit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve në drejtimin e njësisë vendore ku ata kanë vendbanimin" (Vendimi nr.40, datë 16.11.2007).

Detyrimi i parashikuar si rrallë herë nga Kushtetuta për të qenë banor i përhershëm i zonës zgjedhore i lexuar në dritën e detyrimit të vendosur nga neni 67 i Kodit zgjedhor në mënyrë që kandidati për kryetar bashkie apo për këshilltar bashkiak të jetë banor i përhershëm i zonës zgjedhore në momentin e regjistrimit si kandidat pranë KZAZ përkatëse (pra më së paku 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve) nuk përbën asnjë barrë disproporcionale për shtetasit e interesuar, përkundrazi i jep seriozitet garimit dhe formalizon edhe lidhjen e kandidatit me komunitetin vendor. Ndërsa nxit partitë politike që të kërkojnë kandidatura pikërisht në gjirin e këtyre komuniteteve, ky rregullim nuk ndalon as kandidaturat që kanë jetuar e jetojnë jashtë zonës zgjedhore, duke qenë se afati prej 50 ditësh përpara datës së zgjedhjeve është fare minimal dhe i pa konsiderueshëm.

Për sa më sipër kërkesa ankimore e Partisë Bindja Demokratike është e pambështetur në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet rrëzuar.

## PËR KËTO ARSYE



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**  
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 109 të Kushtetutës, nenet 68;70; 71; 72; 73; 124, 143, pika 1, germa "b" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.1, datë 21.05.2019 të Partisë Bindja Demokratike dhe lënien në fuqi të vendimit nr.4, datë 18.05.2019 i KZAZ nr.64 "Për mosregjistrimin e kandidatit për Kryetar Bashkie, Z. Pavllo Shkarpa, Bashkia Berat, propozuar nga Partia Bindja Demokratike.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 646 i Vendimit Data 23.05.2019 e Vendimit Ora 11:00 e Vendimit**  
Për shqyrtimin e kërkesës ankimore Nr. 1, datë 21.05.2019, të paraqitur nga Partia Bindja Demokratike